



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim lyerje dhe mirëmbajtje ndërtesash për Spitalin Rajonal Korçë, për periudhën 2 - vjeçare 2024 - 2025 (Marrëveshje Kuadër)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV: 50800000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,556,837.13 (trembëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjet e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjet e shtatë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

PROCEDURA: E Hapur

AFATI: Marrëveshje Kuadër me një Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Termat E Referencës dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoritete Kontraktore të cilat kërkojnë shërbimin.

Shtojca 8-Kriteret e Vecanta për Kualifikim është hartuar si vijon:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas **Shtojcës 3 të DT**;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas **shtojcës 9 të DT**;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

- **NP 3-A** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **SSH/EN/ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) ose ekuivalent; (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.
- **SSH/EN/ ISO 45001-2018** mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;

Argumentimi: Bazuar në VKM Nr. 285 date 19.05.2021, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron. OHSAS 18001/ISO 45001 – Shëndeti dhe Siguria në Punë. Standardi ISO 45001 specifikon kërkesat për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Ai fokusohet në

kontrollin efektiv të të gjitha risqeve profesionale për të gjitha palët e interesuara (punonjësit, vizitorët, furnitorët, komuniteti lokal, etj.), dhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. ISO 45001 është krijuar për të mbuluar shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe jo sigurinë e produkteve ose proceseve. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e vlerës jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, me kohë të plotë në listëpagesat e tij, jo më pak se 8 (tetë) punonjës për këtë objekt prokurimi, për periudhën **Prill 2024**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

- a) Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën Prill 2024, të konfirmuara nga administrata tatimore.
- b) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën **Prill 2024**.

2.3.3 Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, punonjësit si më poshtë:

NR.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik/Inxhinier Ndertimi	1 (një)
2	Murator	1 (një)
3	Bojaxhi	1 (një)
4	Teknik Ndertimi	1 (një)
5	Hidraulik	1 (një)
6	Elektracist	1 (një)
7	Punëtor Suvatimi	1 (një)
8	Punëtor për shtrimin e pllakave	1 (një)
	Total	8 (tetë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- **Per Drejtuesin Teknik, inxhinier ndertimi**, OE duhet të paraqesë:
 - Diplomë me profesion Inxhinier ndertimi.
 - Kontrate pune perkatëse.
 - Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatëse,
 - Drejtuesi nuk duhet të jete i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Per kete arsye të paraqitet deklarate perkatëse nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.
- Per punonjësit Teknik Ndertimi, Hidraulik, Murator, Elektracist, Bojaxhi Punëtor Suvatimi Punëtor për shtrimin e pllakave, OE duhet të paraqesë:
 - Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
 - Kontrate pune perkatëse.

- Librezë pune, ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën përkatëse.
- **Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik, të punësuar me kohë të plotë:

1 (një) punonjës të certifikuar si specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-së nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Shenim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar të cdo punonjësi pranë AK.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, kërkesë e bërë edhe nga ana e autoritetit kontraktor duke qenë se kontrata do të jetë MK me afat 24 muaj.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 41, pika 4 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekti i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të

ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim:

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të provojë mundësinë e disponimit, të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Kamioncine kapaciteti mbajtes minimalisht 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Gjenerator/motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Depozite uji 1000 L	copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Fikëse zjarri e lëvizshme	copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Betonjere 500 L	copë	1	Në pronësi ose me qira

Shënim:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesi prane AK dokumentacionin Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrsesit.

Mjetet/pajisjet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Shënim:

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratatë të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

